



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E KLINËS
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Klinës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Naser Arllati, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Edon Kabashi udhëheqës i ekipit, Ylber Sadiku dhe Hysen Restelica anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Qeverisja e mirë.....	26
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	29
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	36
Shtojca II: Letër Konfirmimi	39

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 01/11/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Klinës.

Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Komunës së Klinës.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes, ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se informatat e shpalosura në Pasqyrat Financiare Vjetore në lidhje me pasuritë nuk janë të plota dhe të sakta.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:

Theksimi i Çështjes pasqyron dobësitë në kontrole për ta konfirmuar regjistrimin e pasurisë dhe shpalosjen e plota në PVF.



Kryetari duhet t'i analizojë arsyet për Theksimin e Çështjes dhe t'i identifikoj veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurisë në 2019, si dhe shpalosje të plota. (shih çështjet te kapitulli 2).

Kontrollet në menaxhimin e pagesave, shpenzimeve, personelit, obligimeve, prokurimit dhe llogarive të arkëtueshme nuk kanë funksionuar si duhet dhe janë identifikuar parregullsi në këtë raport.



Kryetari duhet të aplikojë një vlerësim të detajuar të fushave të theksuara në këtë Raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe të përcaktoj veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet te kapitulli 3).

Përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak ka një progres, megjithatë ende ka sfida që kërkohen për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.



Kryetari duhet ta zbatoj një proces rigoroz për të siguruar se rekomandimet e vitit paraprak po adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih çështjet te kapitulli 5).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial janë të dobëta. Aktiviteti i Komitetit të auditimit dhe Auditimi i Brendshëm nuk i mbështetë zhvillimet në këtë fushë.



Kryetari duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial për ta ngritur efektivitetin operativ të mbështetur nga një Komitet dhe NJAB më efektive (shih çështjet te kapitulli 4).

Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Klinës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Klinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Komuna përkundër progresit në fushën e pasurive ende nuk kishte arritur të regjistronte tërë pasurinë e paluajtshme në regjistrin e pasurive kapitale. Komisioni i formuar për vlerësimin e pronave kishte nxjerr një listë të pronave bazuar në regjistrat e kadastrit të komunës dhe kishte bërë vlerësimin e tyre bazuar në raportin e departamentit të tatimit në pronë të Ministrisë së Financave, megjithatë rreth 11 hektar nuk ishin evidentuar në regjistrin e pasurive - SIMFK;
- Projekti për "Asfaltimin e rrugës në fshatin Poterq të Epërm" në vlerë prej 284,183€ ishte bashkëfinancim i Komunës dhe Ministrisë së Infrastrukturës. Edhe pse projekti kishte përfunduar dhe ishte bërë pranimi teknik në vitin 2018, ne kemi vërejtur se ende nuk ishte regjistruar si pasuri kapitale. Pjesa e financimit nga Komuna në vlerë prej 117,899€, ishte ende si investim në vijim përderisa pjesa e financimit nga Ministria e Infrastrukturës në vlerë prej 166,284€ nuk ishte transferuar si pasuri e Komunës; dhe
- Po ashtu, pasuritë të cilat komuna nuk i kishte më në pronësi (gjashtë traktorë dhe katër rimorkio) ende nuk ishin fshirë nga regjistri i pasurive.

Kjo gjendje po ndikon në nënvlerësimin apo mbivlerësimin e pasurive dhe po vjen kryesisht për shkak të pakujdesisë dhe mungesës së komunikimit brenda komunës. Opinioni jonë nuk është i modifikuar për këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Planin fillestar dhe final të prokurimit;
- Raportimin e obligimeve të papaguara;
- Pyetëtorin e vet-vlerësimit; dhe
- Raportet e rregullta tremujore për Kuvendin Komunal.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, ndonëse ekzistojnë mangësi në shpalosjet e pasurisë të cilat nuk kanë ndikuar në opinionin e auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura rekomandojmë:

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Të gjitha pasuritë jo financiare, përfshirë pronat të cilat janë të Komunës duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë, ndërsa pasuritë të cilat nuk janë më në pronësi të Komunës duhet të largohen nga regjistrat. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që në PFV 2019 adresohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Klinës kishte shpenzuar 94% të buxhetit final për vitin 2018 që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për të reaguar në arkëtimin e të hyrave në nivel më të lartë dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve në masë më të madhe.

Gjithashtu, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar keq klasifikimin e shpenzimeve, anashkalimin e rregullave të financave, anashkalimin e rregullave të menaxhimit të personelit, rritjen e pagesave me vendime gjyqësore dhe vonesave për përfundimin e projekteve kapitale.

Me tutje, komuna duhet të ndër marrë veprime për të përmirësuar menaxhimin dhe raportimin e plotë të pasurisë dhe menaxhimin më të mirë të obligimeve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	9,694,954	10,070,431	9,485,384	8,742,972	8,271,869
Granti i Qeverisë -Buxheti	8,609,965	8,574,761	8,434,355	7,726,650	7,511,739
Të bartura nga viti paraprak ²	0	217,543	208,725	305,515	196,119
Të hyrat vetjake ³	1,027,944	1,027,944	721,340	614,981	522,829
Donacionet e brendshme	0	47,807	42,064	16,000	31,362
Donacionet e jashtme	0	82,640	78,900	79,826	9,820
Financimi nga huamarrja e jashtme	57,045	119,736	0	0	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 375,477€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të brendshme dhe të jashtme për 130,447€, të hyrave të bartura nga viti paraprak për 217,543€, financimit nga huamarrja e jashtme për 62,691€ dhe zvogëlimit të grantit qeveritar për 35,204€.

Në vitin 2018, OB ka shpenzuar rreth 94% të buxhetit final ose 9,485,384€, niveli i ekzekutimit të buxhetit ishte i njëjtë edhe në vitin 2017.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	9,694,954	10,070,431	9,485,384	8,742,972	8,271,869
Pagat dhe Mëditjet	5,939,849	5,908,624	5,877,181	5,669,197	5,674,868
Mallrat dhe Shërbimet	869,878	927,881	827,091	618,254	606,417
Shërbimet komunale	151,258	151,826	148,912	200,330	161,095
Subvencionet dhe Transferet	65,767	66,013	65,765	76,899	61,656
Investimet Kapitale	2,668,202	3,016,087	2,566,435	2,178,292	1,767,833

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Reduktimi i buxhetit final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte për 31,225€. Realizmi i buxhetit në këtë kategori ishte rreth 99%;

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

- Rritja e buxheti final për mallra dhe shërbime 58,003€, shërbime komunale 568€ si dhe subvencione dhe transfere 246€. Realizmi i buxhetit për mallra dhe shërbime ishte 89%, shërbime komunale 98% ndërsa në kategorinë subvencione dhe transfere rreth 100% po ashtu; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 347,885€. Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit 2018, vetëm 85% e buxhetit ishte shpenzuar. Vonesat kanë të bëjnë me disa projekte të filluara në fund të vitit 2018.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna ishin në vlerë prej 794,033€. Të hyrat janë realizuar nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiraja, taksa administrative, etj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 ⁴ Pranimet
Të hyrat vetjake	1,027,944	1,027,944	794,033	663,268	698,936

Prej gjithsej të hyrave vetjake të planifikuara 1,027,944€, komuna kishte arritur të arkëtoj 77%. Përpos të hyrave të prezantuara në tabelë Komuna kishte edhe të hyra indirekte në vlerë prej 217,487€. Këto ishin nga dënimet në trafik 156,477€ dhe gjobat e gjykatave në vlerë 61,010€.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë më: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqesin në mes të formularëve; rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin më thesar.

Buxheti final për mallrat dhe shërbimet ishte 5,908,624€. Prej tyre ishin shpenzuar 5,877,181€ apo rreth 99% e buxhetit të planifikuar.

⁴ Pranimet për vitin 2016 përfshijnë edhe të hyrat indirekte.

Çështja C2 – Mangësi në menaxhimin e dosjeve dhe rekrutimin e personelit

Gjetja Komuna nuk kishte arritur ende të kompletoj dosjet e personelit në përputhje me Rregulloren Nr. 03/2011 mbi dosjet dhe regjistrin për shërbyesit civil dhe dosjet në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Ne kemi vërejtur se:

- Dosjeve të shërbyesve civil, punonjësve të arsimit dhe shëndetësisë në disa raste ju mungonin dokumentet si: çertifikata e lindjes, kopja e diplomave, vlerësimi i punës, vërtetimi i përvojës së punës, forma e pushimit vjetor dhe mjekësor dhe dëshmi tjera që kërkohen të jenë pjesë e dosjeve të personelit; dhe
- Drejtoria e Arsimit kishte punësuar një mësimdhënës për lëndën e Fizikës Në SHFMU“ Azem Bejta” në Grabanicë, por që konkursin nuk e kishte publikuar në njërin nga mediat e shkruara ashtu siç kërkohet me Udhëzimit Administrativ 07/2017 (MPMS) në nenin 4 pikën 3, por e kishte publikuar në web-faqen e komunës.

Mangësitë në menaxhimin e personelit ishin të shkaktuara nga mungesa e kontrolleve dhe azhurnimi me informatat e kërkuara.

Rreziku Mos azhurnimi dhe kompletimi i dosjeve me dokumentet e nevojshme si dhe mospublikim i konkursit në media të shkruara rrit rrezikun në menaxhim jo adekuat të stafit dhe rekrutimit duke reflektuar me parregullsi dhe mungesë të informatave për stafin e punësuar.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin e kontrolleve mbi dosjet e personelit në mënyrë që të gjitha dosjet të jenë të kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm deri në fund të vitit. Po ashtu, konkurset duhet të shpallen në njërin nga mediat e shkruara.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallrat dhe shërbimet ishte 1,079,707€. Prej tyre ishin shpenzuar 976,003€ apo rreth 90% e buxhetit të planifikuar. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për komunal, udhëtim, telekomunikim, blerje e pajisjeve, derivate dhe lëndë djegëse, shërbime të regjistrimit dhe sigurimit, mirëmbajtje, dreka zyrtare.

Çështja A1 – Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja

Në procedimin e pagesave kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Te pagesa për furnizim me karburante në vlerë prej 1,241€, kemi vërejtur se nuk ishte aplikuar çmimi i berzës së muajit kur ishte bërë furnizimi. Furnizimi sipas faturës dhe fletë dërgesës ishte i muajit Janar 2018⁵ kurse ishte aplikuar çmimi i berzës së muajit dhjetor 2017. Komuna përdorë kontratën për furnizim me karburante të Agjencisë qendrore të prokurimit e cila edhe e publikon në web-faqe çmimin e berzës për secilin muaj që duhet përdorur nga AK. Si rrjedhojë çmimet e paguara mund të devijojnë nga çmimet e duhura; dhe
- Komuna kishte bërë furnizimin me ditar dhe material pedagogjik për shkolla pa ndonjë kontratë. Pagesat ishin ekzekutuar bazuar në çmimoren e përcaktuar nga autorizimi që ka lëshuar Kompania “Dukagjini shpk” për një kompani tjetër. Autorizimi ishte thirrur në vendimin nr. 2/4075 të Ministrisë së Arsimit të datës 01.08.2016. Ne nuk kemi arritur të verifikojmë nëse çmimet e faturuara janë në përputhje me çmimet në kontratën – marrëveshjen e MASHT me kompaninë botuese Dukagjini. Në dosje të pagesës në vlerë prej 4,299€ nuk ka ndonjë informatë të tillë.

Rreziku

Kontrollet jo të duhura në procesin e verifikimit të dosjeve të përgatitura për pagesë rrisin rrezikun që komuna të i ekspozohet rrezikut të pagesave të parregullta dhe kjo të ndikoj në dëmtimin e buxhetit.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj që kontrollet financiare janë efikase në parandalimin e pagesave pa dëshmi relevante. Përgatitja e lëndës për pagesë duhet të procedohet për ekzekutim vetëm pasi të jenë konfirmuar dhe bashkangjitur në dosje të lëndës të gjitha informatat relevante që lidhen me pagesën përkatëse.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 66,013€. Prej tyre ishin shpenzuar 65,765€ apo rreth 100% e buxhetit të planifikuar. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me mbështetje të aktiviteteve kulturore, sportive dhe ndihma momentale.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

⁵ Çmimi për litër i berzës për dhjetor 2017 ishte 1.0339€ kurse për muajin Janar ishte 1,0322€

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,016,087€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,566,435€ apo 85% e buxhetit të planifikuar. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime për rregullim të infrastrukturës, ndërtim i rrugëve, kanalizimit, trotuareve, ndërtim dhe mirëmbajtja e objekteve, pajisje dhe përmirësime të ndryshme të pasurive kapitale.

Çështja C3 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Komuna kishte paguar 39,875€ nga buxheti për investime kapitale për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve (për shkak të keq buxhetimit), ndonëse sipas natyrës këto shërbime janë mirëmbajtje dhe sipas Udhëzimit Administrativ 2005/08 për klasifikim të shpenzimeve i takojnë kategorisë mallra e shërbime.

Rreziku Planifikimi jo i duhur i ndarjeve buxhetore sipas nevojave të komunës, ka ndikuar në keq klasifikimin e shpenzimeve. Klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës.

Rekomandimi C3 Kryetari duhet të siguroj se është bërë planifikimi i drejtë i buxhetit sipas nevojave dhe të sigurojë se në PIP vendosën vetëm ato projekte kapitale për të cilat sigurohet se kanë të bëjnë me përvetësimin e pasurisë për nevojat e komunës. Planifikimi dhe buxhetimi i projekteve të caktuara duhet të bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.

Çështja A2- Lidhja e kontratave në mungesë të zotimeve të mjaftueshme**Gjetja**

Sipas nenit 37.1 të LMFP: Organizata buxhetore nuk ndërmerr asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara. Po ashtu sipas ligjit 06/L-020 për Buxhetin e vitit 2018 neni 12.6: Nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga organizatat buxhetor vetëm në rast se shpenzimet e tilla janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2018 dhe për dy (2) vitet në vijim.

- Te aktiviteti i prokurimit me 4 lloje⁶, komuna kishte lidhur kontratë në mungesë të zotimeve të mjaftueshme. Vlera e kontratës ishte 262,530€, ndërsa mjetet e zotuar para lidhjes së kontratës ishin 130,000€. Duhet theksuar se aktiviteti i prokurimit ishte zhvilluar si projekt dy vjeçar, dhe sipas planit dinamik projektet pritej të përfundonin gjatë vitit 2019, ndërsa sipas ligjit të buxhetit për vitin 2018, këto projekte ishin të planifikuara me vlerë prej 230,000€ dhe nuk kishte mjete të planifikuara për vitet në vijim. Këto projekte ende nuk ishin përfunduar (fondi i marsit 2019); dhe
- Komuna ka lidhur kontratë dy vjeçare për projektin "Asfaltimi i rrugëve në Volljak – Qupevë e Lartë" prej 123,254€ - përderisa në ligjin e buxhetit 2018 ishin të planifikuara dhe të zotuar vetëm 100,000€ dhe nuk ka mjete tjera të planifikuara për vitin 2019.

Po ashtu, Komuna kishte lidhur kontrata në mungesë të zotimeve të mjaftueshme edhe në dy raste tjera:

6

47294 - Asfaltimi i rrugëve lokale në Gllareve-Stapanice-Rixheve, kontrata 141,578.64€ përderisa mjetet e zotuar janë 70,000€;

41258 - Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Sferke, kontrata 49,200.9€ ndërsa mjetet e zotuar janë 45,000€

47189 - Asfaltimi i rrugës lokale ne Kepuz-lagja Lumaj, kontrata 53,722.5€ ndërsa nuk ka pasur mjete te zotuar para lidhjes se kontratës

47193 - Asfaltimi i rrugës në Lagjen Dragaj-Klinavc, kontrata 18,027.5€, mjetet e zotuar janë 15,000€

- Te kontrata për "Asfaltimin e rrugës në Gremnik" prej 84,266€, mjetet e zotuar (pas datës së kontrates) ishin 56,064€ - në ligjin e buxhetit ishin të planifikuara 70,000€ vetëm për vitin 2018. Ka vonesa në kryerjen e puneve ngase projekti ende nuk ka perfunduar gjatë kohës së ekzekutimit të auditimit (fondi i marsit 2019); dhe
- Te kontrata për "Asfaltimin e rrugës në Rastoka" prej 69,939€, mjetet e zotuar (pas datës së kontratës) ishin 60,000€. Projekti kishte perfunduar, ndërsa komuna në mungese të fondeve të zotuar kishte mbetur borxh operatorit në vlerë prej 9,939€.

Sipas zyrtarëve të komunës zotimi i mjeteve është bërë pjesërisht për shkak se financimi shtesë i projekteve ishte planifikuar të sigurohej nga të hyrat vetanake, dhe mjetet do të zotoheshin varësisht prej realizimit të të hyrave.

Rreziku

Mungesa apo zotimet më të ulëta se vlera e kontraktuar me rastin e nënshkrimit të kontratave kanë ekspozuar komunën para një rreziku të hyrjes në obligime përtej shumës që tejkalon fondet e ndara dhe ndikon në prolongimin e realizimit të projekteve të planifikuara.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin plotë të tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetanake apo fonde tjera të financimit.

Çështja A3 - Punët shtesë jashtë kontratës bazë si dukuri

Gjetja Komuna gjatë vitit 2018 kishte lidhur 21 aneks kontrata për punë shtesë (kontrata për punë në total ishin 57) në vlerë prej 216,842€. Aneks kontratat kryesisht ishin për asfaltimin e rrugëve, ndërtimin e kanalizimit dhe renovimin e objekteve të ndryshme. Punët shtesë janë arsyetuar nga menaxheri i kontratës dhe ZKA dhe lejohen edhe me ligj, megjithatë vërehet se kjo ishte bërë dukuri e shpeshtë gjatë vitit 2018, dhe kryesisht ishin për shkak të planifikimit dhe menaxhimit jo të mirë të projekteve kapitale. Sipas zyrtarëve të komunës, arsytet e numrit të lartë të aneks kontratave janë: kërkesat e banorëve për zgjatjen e rrugëve dhe asfaltimin e segmenteve të reja, zgjatjen e rrjetit të kanalizimit, për shkak të punëve të paplanifikuara dhe pengesat lidhur me problemet pronësore.

Ne kemi bërë ekzaminim fizik për punët shtesë në kontratën “Asfaltimi i rrugës në Ujmir” prej 7,218€, dhe kemi vërejtur se ishte asfaltuar një segment i ri i cili nuk ishte i paraparë në projektin ekzekutiv, mirëpo nuk i plotësonte kushtet e përcaktuara me ligjin e prokurimit⁷ dhe projekti mund të kompletohej edhe pa asfaltimin e këtij segmenti.

Rreziku Numri i lartë i aneks kontratave shpërfaq mangësitë në planifikimin dhe menaxhimin e projekteve kapitale duke krijuar kosto shtesë të projekteve aktuale. Po ashtu, punët shtesë i rrezikojnë fondet e ndara për projekte tjera duke pamundësuar financimin e projekteve të reja.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha projektet kapitale janë të planifikuara, hartuara dhe të detajuara mirë përpara inicimit të procesit të prokurimit me qëllim të menaxhimit efektiv të fondeve të këtyre projekteve. Po ashtu, duhet të sigurojë se aneks kontrata përdoret në rastet e jashtëzakonshme dhe vetëm pas plotësimit të kushteve të përcaktuara me ligjin e prokurimit.

⁷ Sipas nenit 35.2.4(i) të LPP, autoriteti kontraktues mund ta përdor procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për punë ose shërbime shtesë që nuk janë përfshirë në kontratën origjinale që u nënshtrohen disa kushteve të caktuara: OE i njëjtë ekzekuton punët/shërbimet shtesë, që punët e tilla shtesë nuk mund të ndahen në mënyrë teknike ose ekonomike, megjithëse si të ndara janë tejet të nevojshme për kompletim.

Çështja A4 - Vonesa në realizimin e kontratave

Gjetja Nga pagesat e testuara kemi evidentuar vonesa në realizimin e punëve në katër projekte kapitale si:

- Te kontrata “Ndërtimi i sheshit, rrugëve të qytetit, infrastruktura nëntokësore dhe mbitokësore” në vlerë prej 1,423,328€, punët ishte dashur të përfundonin në vitin 2017, dhe ato ende nuk ishin të përfunduar. Penalet nuk ishin aplikuar me arsyetimin se vonesat në realizimin e punëve sipas organit mbikëqyrës dhe menaxherit të kontratës kryesisht ishin për shkak ndryshimit në projektin e elektrikes, punëve shtesë, kushteve atmosferike, dhe kërkesave të komunës që të krijohen kushte për qarkullimin e qytetarëve nëpër punishte; dhe
- Po ashtu vonesa në realizimin e kontratave kemi identifikuar edhe në tre projekte tjera, si te “Asfaltimi i rrugës në Gremnik” prej 84,266€, “Asfaltimi i rrugës në Radullovc” prej 44,752€ dhe “Ndërtimi i ujësjellësit në Radullovc” prej 18,988€. Këto projekte sipas planeve dinamike ishte dashur të përfundonin gjatë vitit 2018, mirëpo kemi evidentuar se ato ende nuk ishin përfunduara gjatë kohës që ne ishim në ekzekutim të auditimit (fundi i marsit 2019), dhe nuk kishte aplikim të penaleve.

Duhet theksuar se nuk na është ofruar ndonjë dëshmi lidhur me kërkesën e punëkryesit e as ndonjë aprovim të komunës për zgjatjen e afatit për realizimin e kontratës, ashtu siç kërkohet nga dosja e tenderit për kontratat e punëve lidhur me vonesat në realizimin e kontratave neni 17 dhe 18.

Rreziku Vonesat në realizimin e kontratave rrisin rrezikun që obligimet të barten në fund të vitit, dhe të cilat pastaj do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues dhe krejt kjo të reflektojë edhe në arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave në raportet e tyre ofrojnë informata të mjaftueshme rreth ecurisë së implementimit të kontratave dhe të formalizojnë procesin e shtyerjes së afateve kur ato janë të justifikuara nga ana e Komunës. Po ashtu, duhet të shtohen masat e kontrollit dhe në rastet kur ka vonesa të pa arsyetuara të aplikohen penalet për ditët në vonesë.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja B1- Pagesat e ekzekutuara nga Thesari për vendimet gjyqësore / përmbartimore e

Gjetja Neni 39 i LMFPF përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim.

Ne kemi identifikuar se ishin ekzekutuar në bazë të vendimeve gjyqësore pagesa në vlerë prej 117,119€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 109,793€, kamata për vonesa në pagesë 1,420€ dhe shpenzime procedurale të gjykatës (përmbartimit) ishin 5,906€. Po ashtu, kjo formë e pagesave nga thesari ka ndikuar në marrjen e mjeteve nga kategoritë ekonomike jo adekuate.

Rreziku Shumat e ekzekutuara të pagesave në bazë të vendimeve gjyqësore krijojnë shpenzime shtesë duke reflektuar në prishjen e bilancit buxhetor e shpeshherë edhe keqklasifikim të shpenzimeve. Pagesat e ekzekutuara në këtë mënyrë rrezikojnë fondet e projekteve të planifikuara.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë e detajuar për shkaqet e ekzekutimit të pagesave me vendime gjyqësore dhe të ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e tyre me qëllim të eliminimit të pagesave shtesë për vendime gjyqësore.

Çështja A5 - Mungesë e planeve për menaxhimin e kontratave

Gjetja Në 12⁸ kontrata, planet për menaxhimin e kontratave nuk ishin të nënshkruara nga palët kontraktuese, që nënkupton që nuk kishte plane të dakorduara në mes palëve kontraktuese. Në disa raste ato ishin të panënshkruara nga ana e Komunës e në disa raste tjera nga ana e OE. Kryesisht planet për menaxhimin e kontratave hartoheshin vetëm sa për të përmbushur kërkesat formale por jo edhe që të shërbejnë si një bazë e mirë për të monitoruar procesin e përmbushjes konform ecurisë së realizimit të kontratave.

Rreziku Mos aplikimi/azhurnimi i planit për menaxhimin e kontratës pa mundëson pasqyrimin e një gjendjeje reale të realizimit të kontratës dhe rrezikon në menaxhimin jo adekuat të kontratave.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të siguroj se procesit të menaxhimit të kontratave i paraprinë një plan i dakorduar (nënshkruar) në mes palëve si një bazë e mirë për menaxhimin e kontratave dhe ku definohen kushtet, afatet dhe aspektet tjera të realizimit të kontratave. Po ashtu, plani duhet të azhurnohet me kohë në bazë të ecurisë së realizimit të kontratave.

⁸ Te Investimet Kapitale në 8 raste dhe te Mallrat e Shërbimet në 4 raste

Çështja A6 – Parregullsi procedurale në ekzekutimin e pagesave

Gjetja

Me rregullat e menaxhimit të financave publike çdo vit Thesari me aprovimin e ZKA së Organizatës e bënë emërimin dhe fletëdeponimin e nënshkrimeve të personelit të caktuar dhe lejon qasjen në SIMFK. Në procesin e pagesave kemi evidentuar mangësitë si në vijim:

- Në 10 Urdhër pagesa (CPO) në vlerë prej 294,554€ kemi vërejtur se urdhërpagesat (kopja fizike) nuk ishin të nënshkruara nga zyrtari shpenzues, përderisa në 4 Urdhër pagesa (CPO) në vlerë prej 50,309€ kemi vërejtur se urdhërpagesat nuk ishin të nënshkruara nga zyrtari certifikues; dhe
- Në të gjitha mostrat e testuara raporti i pranimi i cili gjenerohet nga SIMFK nuk ishte nënshkruar nga zyrtari i autorizuar për pranim, por ishte nënshkruar nga njëri prej anëtarëve të komisionit të cilët ishin organ mbikëqyrës për pranimin e punëve apo mallrave e shërbimeve. Kjo praktikë është në kundërshtim me kërkesat e Procedurës për menaxhimin e qasjes së përdoruesve në SIMFK pjesa 9.8: klasa funksionale 8 përdoret nga zyrtarët e pranimi të mallit të cilët bëjnë regjistrimin e pranimi të mallit në SIMFK.

Kjo ka ndodhur për shkak se zyrtarët kishin qenë në pushim mjekësor/vjetore dhe nuk kishte ndonjë zyrtar alternativë që e zëvendëson pozitën e tyre gjatë kohës kur ishin në pushim qoftë shpenzuesi / certifikuesi. Zyrtari certifikues dhe zyrtari shpenzues kishin zëvendësuar njëri-tjetrin në sistem gjatë shfrytëzimit të pushimit mjekësor apo vjetor.

Rreziku

Fakti që autorizimet për nënshkrime janë për persona të caktuar nënkupton që të drejtën për nënshkrim e kanë vetëm këta persona e jo edhe të tjerët në këto dokumente që gjenerohen nga SIMFK-ja. Mungesa e nënshkrimit të zyrtarit certifikues/shpenzues, dhe zyrtarit të pranimi rrit rrezikun që kontrollet nuk janë duke u aplikuar në të gjitha rastet dhe kjo mund të ketë efekt negativ që gjatë ekzekutimit të pagesave të rezultojnë edhe pagesa të pa rregullta.

Rekomandimi A6 Kryetari të siguroj se kontrollet në lidhje me procedimin e pagesave janë duke u zbatuar nga personat e autorizuar dhe asnjë pagesë nuk bëhet deri sa në dokumentet e nevojshme për pagesë nuk janë të nënshkruara nga personat e autorizuar. Po ashtu, duhet siguar që për çdo zyrtarë të autorizuar në rast të mungesës së tyre, të kenë zyrtarët alternativë.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrimit kontabël të SIMFK-së, vlera neto e pasurive kapitale (mbi 1,000€) është 81,687,387€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1,000€) është prezantuar 223,787€.

Çështja A7 - Dobësi në azhurnimin e regjistrit të pasurive

Neni 6.1 i Rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare kërkon që çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Po ashtu sipas nenit 6.3: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Ne kemi vërejtur se

- Në 5 raste të shpenzimeve kapitale dhe jo kapitale prej 20,228€ të cilat nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive jo financiare. Prej tyre 3 raste me vlerë 17,698€ nuk janë regjistruar në SIMFK dhe 2 raste prej 2,530€ në e-pasuria;
- Neni 15.2 i rregullores kërkon që përmirësimet të regjistrohen si rritje e vlerës së pasurive jo financiare kapitale. Kemi evidentuar se mirëmbajtja e rrugëve me asfalt prej 8,873€ ishte regjistruar si artikull i ri në regjistrin kontabël, ndonëse ishte përmirësim i pasurisë dhe duhej ti rritej vlera rrugëve në të cilat ishte bërë përmirësimi; dhe
- Në regjistrin e pasurive kapitale ishte regjistruar pagesa prej 8,745€ për pajisjet mjekësore, ndonëse prej tyre vetëm vlera prej 2,080€ i plotësonte kriteret e pasurive kapitale ndërsa pjesa tjetër është dashur të regjistrohej tek E-pasuria.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive.

Rreziku

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që e posedon komuna dhe si pasojë kemi mbi/nënvlerësim të pasurive që reflektojnë edhe në prezantimin jo të drejtë të pasurive në pasqyra financiare.

Rekomandimi A7 Kryetari, duhet të sigurohet që regjistri i pasurive azhurnohet me të gjitha informatat relevante në mënyrë që të gjitha pasuritë e Komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive si dhe pasuritë që nuk janë në posedim të komunës ti heqë nga regjistrat e pasurive konform rregullave të pasurisë. Po ashtu, të mbështetet dhe përkrahet stafi me trajnimet përkatëse për eliminimin e dobësive në menaxhimin e pasurisë.

Çështja B2 -Vonesa në kryerjen e inventarizimit dhe mungesa e bar kodeve

Gjetja

Rregullorja për menaxhimin e pasurive kërkon që raporti i inventarizimit të kryhet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Ne kemi vërejtur se:

- Komuna në fund të vitit ka themeluar komisionin për inventarizim, mirëpo inventarizimi ishte kryer me vonesë për drejtorinë e arsimit. Komuna nuk kishte udhëzime të brendshme të aprovuara lidhur me inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive jo financiare kërkesë e nenit 19.5.3 dhe 21.5.3 i rregullores nr. 02/2013. Përkundër vonesave kishte progres në regjistrim të pasurisë sepse ishin bërë plotësime në regjistrin e e-pasurisë duke shfrytëzuar informatat nga raporti i inventarizimit në drejtorinë e arsimit dhe shëndetësisë; dhe
- Kemi evidentuar se komuna ende nuk ka filluar aplikimin e numrave të barkodit për pasuritë jo financiare ndonëse sipas nenit 6.4.5 të rregullës financiare 02/2013 ku kërkohet që regjistri i pasurive të përfshijë edhe numrin e barkodit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së njohurive të stafit të angazhuar në kryerjen e inventarizimit të pasurive dhe mungesës së udhëzimeve të brendshme të aprovuara lidhur me inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive jo financiare.

Rreziku

Angazhimi jo i duhur për azhurnimin e regjistrit të pasurisë reflekton mungesë të informatave të sakta dhe të plota lidhur me pasurinë në posedim. Kjo rritë rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet, apo tjetërsohet dhe njëherësh ndikon në prezantim jo të drejtë të gjendjes së tyre në PFV.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë që komisioni ka përfunduar raportin e inventarizimit plotësisht para përgatitjes së PFV-ve. Raporti duhet të përfshijë krahasimin e gjendjes fizike me atë në gjendjen e regjistrave. Nëse konstatohen diferenca ato duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël. Po ashtu, pasuritë duhet të pajisen me barkode.

3.3 Të arkëtueshmet

Komuna ka prezantuar llogari të arkëtueshme në vlerë totale 2,093,065€ që kanë të bëjnë me: tatimin në pronë 1,333,741€, ngarkesa për afarizëm të bizneseve 562,944€ dhe dhënia në shfrytëzim e pasurisë me qira 196,380€. Në vitin paraprak të arkëtueshmet ishin 1,923,000€.

Çështja B3 – Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Komuna nuk ka ndonjë plan operativ për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe nuk ka ndërmarr ndonjë veprim për arkëtimin e këtyre borxheve përmes përmbaruesve. Trendi i të arkëtueshmeve është në rritje të vazhdueshme nga viti në vit gjersa krahasuar me vitin paraprak janë rritur borxhet për rreth 9%. Rritja më e madhe ka ndodhur te tatimi në pronë.

Sfida kishte edhe të arkëtimet nga prona e dhënë me qira. Komuna kishte dhënë me kohëzgjatje deri në 10 vite në shfrytëzim dhe menaxhim tregun e gjelbër me çmim të qirasë prej 515€ për muaj. Bazuar në nenin 3 paragrafi 3.1 të kontratës është paraparë që operatori është i obliguar të paguaj qiranë mujore 15 ditë pas përfundimit të muajit paraprak. Ne kemi verifikuar se kishte vonesa në arkëtim të qirasë deri në tre muaj. Shkaqet e rritjes së të arkëtueshmeve janë ndikuar nga veprimi i pamjaftueshëm i Komunës përkundër faktit se janë bërë disa përpjekje që përmes përmbaruesve privat të rrisë mbledhjen e të arkëtueshmeve nga taksa në biznes.

Rreziku Rreziku i mos arkëtimin të të hyrave ndikon që shumë projekte kapitale të mos realizohet për shkak të mungesës së mjeteve. Mungesa e kontrollit dhe mos aplikimi i masave adekuate pamundëson arkëtimin dhe rrit rrezikun e vjetërimit të kërkesave.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet të intensifikohen aktivitetet përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve për rritjen e arkëtimit, kurse te qiramarrësit borxhli të merren masa për arkëtimin me kohë të qirasë.

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 61,452€ e prezantuar në pasqyra financiare. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Detyrimet kontingjente ishin në vlerë prej 161,000€ që krahasuar me vitin paraprak ishin rritur për 68,000€. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Komuna.

Çështja B4 - Vonesa në pagesën e faturave të papaguara

Gjetja Neni 39 i LMFPF përcakton afatin e pagesës brenda 30 ditëve nga pranimi i faturës. Kemi evidentuar 4 raste prej 8,153€⁹ në të cilat komuna ishte vonuar prej 20 deri 70 ditë në pagesën e obligimeve ndaj furnitorëve.

Sipas zyrtarëve të komunës, vonesat ishin kryesisht për shkak të mungesës së mjeteve për pagesën e tyre, përderisa në kemi identifikuar se komuna në disa raste ka hyrë në obligime kontraktuale në mungesë të mjeteve të mjaftueshme.

Rreziku Hyrja në obligime pa mbulesë të mjeteve dhe vonesat në pagesa mund të ndikojë në rritjen e obligimeve të cilat krijojnë implikime buxhetore për vitin vijues dhe rrezikojnë të shkaktohen shpenzimeve shtesë për shkak të pagesave sipas vendimeve gjyqësore/përmbartimore.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurohet se komuna nuk hyn në obligime kontraktuale në mungesë të mjeteve të mjaftueshme dhe të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

⁹ Fatura për servisimin dhe mbushjen e aparateve kundër zjarrit 1,393€, renovimi i shkollës në Caravik 1,545€, furnizimi me dru 4,416€ dhe furnizimi me artikuj ushqimorë për çerdhe 799€.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda Komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe mungesa e statutit të Komitetit të Auditimit e bëjnë sistemin e auditimit të brendshëm, jo shumë efikas.

Të gjitha Komunitat janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent. Komuna posedon strategjinë e zhvillimit ekonomik 2017-2021, megjithatë, ende nuk posedon “Hartën Zonale të Komunës” por vetëm është marrë vendimi për hartimin e saj me datën 24.02.2017, e që deri më tani nuk ka ndodhur hartimi i saj.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në Komunën e Klinës funksionon Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) e cila operon me dy auditor. NjAB kishte hartuar planin strategjik, dhe vjetor të punës ku ishin planifikuar gjashtë auditime, të cilat edhe ishin realizuar. Po ashtu, ekziston edhe Komiteti i Auditimit i cili kishte mbajtur gjashtë takime gjatë vitit 2018.

Auditimet kanë mbuluar: menaxhimin e automjeteve në administratën komunale dhe shëndetësi, të hyrat vetjake në drejtorinë e arsimit dhe shëndetësisë, shpenzimet për investime kapitale rrugore, shpenzimet e rrymës në administratën komunale, shpenzimet për telefona mobil dhe fiks si dhe sistemin organizativ/protokollet/efikasiteti i menaxhimit në drejtorinë e shëndetësisë/QKMF.

Çështja C4 - Funksionimi i kufizuar i Komitetit të Auditimit

Gjetja Auditimi ynë ka identifikuar disa dobësi në sistemin e auditimit të brendshëm për faktin që Komiteti i auditimit (KA) nuk kishte përgatitur dhe nxjerr statutin e saj i cili duhej nënshkruhej nga anëtarët e komitetit. Po ashtu, menaxhmenti i komunës si dhe komiteti ishte pasiv sa i përket rolit të vet, pasi që gjatë takimeve komiteti kishte marrë vetëm informata nga NJAB-i por nuk kishte marrë ndonjë vendim, për të forcuar rolin e NjAB-së.

Rreziku Mungesa e efektivitetit të Komitetit të Auditimit redukon aftësinë e mbikëqyrjes së aktiviteteve të NjAB-së dhe fuqizimin e mëtejshëm të rolit të auditimit të brendshëm. Si rrjedhojë, kjo mund të ndikojë në mos adresimin e dobësive në sistemin e kontroleve të brendshme.

Rekomandimi C4 Kryetari duhet të sigurojë që KA ka nxjerr statutin dhe merr një rol pro-aktiv në mënyrë që të arrihet përfitimi maksimal nga sistemi i auditimit të brendshëm. KA duhet t'i rishikojë në mënyrë kritike burimet, planet dhe rezultatet e NjAB dhe të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të komunës.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalesje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuar janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar.

Çështja B5 – Dobësi në kontrolle menaxheriale dhe menaxhim të rrezikut

Gjetja Pavarësisht se linjat e llogaridhënies dhe të komunikimit ishin funksionale përmes takimeve të rregullta javore, formati aktual i raportimeve menaxheriale nuk ofron bazë për kontrolle të brendshme efektive meqenëse raportimi me shkrim tek menaxhmenti i lartë bëhet vetëm sipas kërkesës dhe jo në baza të rregullta kohore. Si pasojë e kontrolleve jo të mira janë vërejtur dobësi në fushën e prokurimit, pagesën e shpenzimeve, në regjistrimin e pasurisë si dhe arkëtimin e borxheve.

Komuna gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve. Nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, ku do të bëhej identifikimi i rreziqeve të pritshme kundrejt objektivave, përcaktimi i mënyrës së menaxhimit të tyre dhe njësitë përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme. Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës zyrtarëve përgjegjës.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2017 të Komunës së Klinës ka rezultuar me 16 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet e dhëna. Megjithatë, nuk janë marrë veprime të mjaftueshme pasi që plani i veprimit nuk është zbatuar në tërësi dhe mangësitë e njëjta vazhdojnë të përsëriten në disa fusha.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, vetëm gjashtë (6) rekomandime ishin zbatuar plotësisht, katër (4) ishin në proces të zbatimit, ndërsa pesë (5) nuk janë zbatuar ende. Po ashtu një rekomandim ishte i mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikim dhe Theksim të Çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet te prezantimi i shënimeve në PVF. Me tutje, e gjitha pasuria, përfshirë pronat të cilat i posedojnë si dhe pasuritë jo financiare duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë, ndërsa pasuritë të cilat nuk janë më në pronësi të Komunës duhet të largohen nga regjistrat.</p> <p>Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.</p>	<p>Komuna ka ndërmarrë masa lidhur me adresimin e pronave komunale, janë evidentuar parcelat që duhet të regjistrohen si dhe plotësimi i regjistrat në sistemin e pasurisë te drejtoria e arsimit dhe shëndetësisë ishte duke u kompletuar. Mbetet sfida pastrimi i regjistrave prej pasurive që nuk janë në pronësi të komunës.</p>	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
2	Të hyrat	<p>Kryetari i komunës duhet të siguroj se janë ndërmarr veprimet e nevojshme për kalkulimin e drejtë të ngarkesave tatimore ndaj taksapaguesve duke aplikuar kriterin e cilësisë se objekteve në përputhjeje me koeficientet e përcaktuar nga ligjvënësi.</p>	<p>Menaxhmenti kishte marrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimit.</p>	Rekomandim i zbatuar
3	Pagat dhe shtesat	<p>Kryetari duhet t'i rishikojë arsyet e mos ndjekjes së procedurave të punësimit siç parashihen me legjislacionin përkatës dhe të vendosë kontrolle të duhura për të siguar që punësimi i zyrtareve bëhet vetëm përmes konkursit publik.</p>	<p>Në këtë vit kishim vetëm një rast të identifikuar pa e shpallur, por që kishte edhe mangësi në dosje.</p>	Rekomandim pjesërisht i zbatuar

4	Subvencione dhe transfere	Kryetari duhet të sigurojë se përfituesit e subvencioneve raportojnë për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve, dhe në rastet kur mjetet nuk shfrytëzohen për qëllimin e dhënë të ndërmerren masa ligjore ndaj përfituesve të subvencioneve.	Ishin marrë masa nga menaxhmenti, përfituesit raportojnë për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve.	Rekomandim i zbatuar
5	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve do të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe se në rast të mospërputhjeve ndërmjet dispozitave të LPP-së dhe dispozitave të Rregullores së PP-së dominojnë dispozitat e LPP-së. Megjithatë në rastet të tilla mund të kërkohej interpretim ligjor nga KRPP-ja.	Nuk kemi identifikuar raste të ngjashme gjatë testimeve tona.	Rekomandim i zbatuar
6		Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur kontrole funksionale që garantojnë një vlerësim të saktë të ofertave në përputhje me kërkesat ligjore me qëllim të maksimizimit të vlerës për paratë e shpenzuar.	Nuk kemi identifikuar raste të ngjashme gjatë testimeve tona.	Rekomandim i zbatuar
7		Kryetari duhet të sigurojë se regjistrimi i shpenzimeve bëhet në kode adekuat siç parashihet me planin kontabël të SIMFK-së me qëllim të prezantimit dhe shpalosjes së informacionit të drejtë për shfrytëzuesin e raporteve financiare.	Janë vërejtur keqklasifikime në kategori por jo në kode ekonomike.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
8	Çështjet e përbashkëta për mallrat /shërbimet si dhe investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë e detajuar për shkaqet e ekzekutimit të pagesave me vendime gjyqësore dhe të ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e tyre me qëllim eliminim të pagesave shtesë për vendime gjyqësore.	Mbetet ende sfidë dhe me një tendencë të rritjes.	Rekomandim i pa zbatuar
9		Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projektit për secilën kontratë, komisionet për mbikëqyrje dhe pranimit teknik, formohen me vendimin e zyrtarit kompetent bazuar në	Janë marrë veprimet e duhura.	Rekomandim i zbatuar

		legjislacionin në fuqi. Po ashtu planet për menaxhimin e kontratave duhet të përgatiten nga zyrtaret përgjegjës.		
10		Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese kryejnë vlerësimet e përafërta për qëllime furnizimi/blerjeje para inicimit të aktiviteteve të prokurimit për lidhjen e kontratave publike kornizë siç parashihet me LPP-në.	Janë marrë veprimet për zbatimin e rekomandimit.	Rekomandim i zbatuar
11	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që komisioni ka përfunduar raportin e inventarizimit para përgatitjes së PFV-ve. Raporti duhet të përfshijë krahasimin e gjendjes fizike me atë në gjendjen e regjistrave. Nëse konstatohen diferenca ato duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.	Kishte progres por mbetet ende sfidë që inventarizimi të kryhet me kohë dhe krahasoj regjistrat.	Rekomandim i pa zbatuar
12	Të arkëtushmet	Kryetari duhet të shqyrtoj në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se të hyrat e dakorduara janë realizuar.	Nuk ishin marrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimit.	Rekomandim i pa zbatuar
13	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës siç kërkohet me LMFFPP.	Edhe këtë vit janë identifikuar raste të vonesave.	Rekomandim i pa zbatuar
14	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore apo tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.	Rekomandimi mbyllur.	Rekomandim i mbyllur
15	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të analizojë shkaqet e mosfunksionimit të Komitetit të Auditimit dhe të ndërmerren veprime për të siguruar një funksionim efektiv dhe të plotë të Komitetit të Auditimit, si dhe të përgatisë	Ishin përgatitur planet për adresimin e rekomandimeve por mbetet sfidë	Rekomandim pjesërisht i zbatuar

		dhe të zbatojë planin për zbatimin e rekomandimeve të NjAB-it për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e NjAB-së.	e komitetit të auditimit në funksionimin e plotë dhe efektivë.	
16	Raportimi menaxherial	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.	Ende mbetet sfidë dhe nuk ishte ndërmarrë veprim në zgjidhjen e kësaj çështjeje.	Rekomandim i pa zbatuar
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV - ref. C1	Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Të gjitha pasuritë jo financiare, përfshirë pronat të cilat janë të Komunës duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë, ndërsa pasuritë të cilat nuk janë më në pronësi të Komunës duhet të largohen nga regjistrat. Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që në PFV 2019 adresohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme.		
2	Paga dhe Meditje - ref C2	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin e kontrolleve mbi dosjet e personelit në mënyrë që të gjitha dosjet të jenë të kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm deri në fund të vitit. Po ashtu, konkurset duhet të shpallen në mediat e shkruara.		
3	Mallra dhe Shërbime - refA1	Kryetari duhet të siguroj që kontrollet financiare janë efikase në parandalimin e pagesave pa dëshmi relevante. Përgatitja e lëndës për pagesë duhet bërë vetëm pasi të jenë konfirmuar dhe bashkangjitur në dosje të lëndës të gjitha informatat relevante që lidhen me pagesën përkatëse.		
4	Investimet Kapitale - ref. C3	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë planifikimi i drejtë i buxhetit sipas nevojave dhe të sigurojë se në PIP vendosën vetëm ato projekte kapitale për të cilat sigurohet se kanë të bëjnë me përvetësimin e pasurisë për nevojat e komunës. Planifikimi dhe buxhetimi i projekteve të caktuara duhet të bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.		

5	Investimet Kapitale - ref. A2	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetanake apo fonde tjera të financimit.
6	Investimet Kapitale - ref. A3	Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha projektet kapitale janë të planifikuara, hartuara dhe të detajuara mirë me qëllim të menaxhimit të fondeve të tyre dhe duhet të sigurojë se aneks kontrata përdoret në rastet e jashtëzakonshme dhe vetëm pas plotësimit të kushteve të përcaktuara me ligjin e prokurimit.
7	Investimet Kapitale - ref. A4	Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave në raportet e tyre ofrojnë informata të mjaftueshme rreth ecurisë së implementimit të kontratave dhe të formalizojnë procesin e shtyrjes së afateve kur ato janë të justifikuara nga ana e Komunës. Po ashtu duhet të shtohen masat e kontrollit dhe në rastet kur ka vonesa të pa arsyeuara të aplikohen penalet për ditët në vonesë.
8	Çështjet e përbashkët a IK dhe M&SH - Ref B1	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë e detajuar për shkaqet e ekzekutimit të pagesave me vendime gjyqësore dhe të ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e tyre me qëllim eliminim e pagesave shtesë për vendime gjyqësore.
9	Çështjet e përbashkët a IK dhe M&SH - Ref A5	Kryetari duhet të siguroj se procesit të menaxhimit të kontratave i paraprinë një plan i dakorduar (nënshkruar) në mes palëve si një bazë e mirë për menaxhimin e kontratave dhe ku definohen kushtet, afatet dhe aspektet tjera të realizimit të kontratave. Po ashtu, plani duhet të azhurnohet me kohë në bazë të ecurisë së realizimit të kontratave.
10	Çështjet e përbashkët a IK dhe M&SH - Ref A6	Kryetari të siguroj se kontrollet në lidhje me procedimin e pagesave janë duke u zbatuar nga personat e autorizuar dhe asnjë pagesë nuk bëhet deri sa në dokumentet e nevojshme për pagesë nuk janë të nënshkruara nga personat e autorizuar. Po ashtu, duhet siguruar që për çdo zyrtarë të autorizuar në rast të mungesës së tyre, të kenë zyrtarët alternativë.
11	Menaxhimi i Pasurive - ref A7	Kryetari, duhet të sigurohet që regjistri i pasurive azhurnohet me të gjitha informata relevante në mënyrë që të gjitha pasuritë e Komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive si dhe pasuritë që nuk janë në posedim të komunës ti heqë nga regjistrat e pasurive konform rregullave të pasurisë. Po ashtu, të mbështetet dhe përkrahet stafi me trajnimet përkatëse për eliminimin e dobësive në menaxhimin e pasurisë.

12	Menaxhimi i Pasurive – ref B2	Kryetari duhet të sigurojë që komisioni ka përfunduar raportin e inventarizimit plotësisht para përgatitjes së PFV-ve. Raporti duhet të përfshijë krahasimin e gjendjes fizike me atë në gjendjen e regjistrave. Nëse konstatohen diferenca ato duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël. Po ashtu, pasuritë duhet të pajisen me barkode.
13	Llogaritë e arkëtuesh me - ref B3	Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet të intensifikohen aktivitetet përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbauesve për rritjen e arkëtimit, kurse të qiramarrësit borxhli të merren masa për arkëtimin me kohë të qirasë.
14	Obligimet e papaguara - ref B4	Kryetari duhet të sigurohet se komuna nuk hyn në obligime kontraktuale në mungesë të mjeteve të mjaftueshme dhe të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës.
15	Sistemi i AB –ref C4	Kryetari duhet të sigurojë që KA ka nxjerr statutin dhe merr një rol pro-aktiv në mënyrë që të arrihet përfitimi maksimal nga sistemi i auditimit të brendshëm. KA duhet t'i rishikojë në mënyrë kritike burimet, planet dhe rezultatet e NjAB dhe të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të komunës.
16	Raportimi menaxherial – menaxhimi i rrezikut ref. B5	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Klinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Zenun Elezaj 

Kryetar i Komunës së Klinës,

Data: 17.05.2019, Klinë,